Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr. Prot. 75/22
Datë 15.04.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Psh. nr. 75/22

KRYESUESI I SEKRETARIATIT TË OSHP-së, në mbështetje të nenit 53, të Ligjit me nr. 05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative, bën anulim të vendimit të OSHP-së, me nr. 75/22, të protokolluar me datë 29.03.2022, që ndërlidhet me procedurën e prokurimit: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi " 70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional- Prizren, më datën 15. 04. 2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **SHFUQIZOHET**, vendimi i OSHP-së, nr. 75/22, i protokolluar me datë 29.03.2022, që lidhet me procedurën e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me Nr. prokurimi "70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional- Prizren.

II. **PEZULLOHET**, procedura e prokurimit në autoritetin kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me nr. prokurimi "70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional- Prizren, deri në nxjerrjen e vendimit tjetër.

III. Organi Shqyrtues i Prokurimit do të vazhdoj me procedimin e ankesës së OE "VLERA" SH.P.K. me seli në Shtime, me numër të protokollit 75/22, i protokolluar me datë 29.02.2022, të parashtruar kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me nr. prokurimi "70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional- Prizren, në pajtim me nenin 113, 114, 116 dhe 117 të LPP-së.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik **"Vlera" SH.P.K. - Shtimje**, më datën 03 prill 2022, përmes shkresës, ka kërkuar nga OSHP, korrigjimin dhe rishqyrtimin e vendimit të datës 29 mars 2022, me numër te protokollit 75/22, me arsyetimin se ankesa e tyre është hedhur poshtë si e palejuar për humbje të afatit ligjor.

Kryesuesi i Sekretariatit ka kërkuar nga zyra për pranim të ankesave në OSHP një sqarim më të detajuar të ankesës dhe të njëjtit në përgjigjen me shkrim kanë deklaruar: Se pas pranimit me e-prokurim të parashtresës së operatorit ekonomik te cilet kanë kërkuar anulim të vendimit dhe kanë sqaruar se të njëjtit kanë dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor, zyra për pranim të ankesave kanë kalkuluar edhe njëherë afatet ligjore dhe ka rezultauar që është lëshuar një gabim në data, sepse dita e fundit i ka rënë të jetë e diele, ditë pushimi dhe për këtë arsye ata si zyrë nuk e kanë kalkuar si datë të fundit datën 14 mars 2022, ditë e hënë, duke e konsideruar keshtu si te paafatshme kerkesen e operatorit ekonomik per rishqyrtim.

Kryesuesi i Sekreatariatit poashtu ka kërkuar një intepretim nga zyra ligjore e OSHP-se dhe një intepretim të KRPP, por këta të fundit nuk i janë përgjigjur me shkrim.
Sipas zyres ligjore në OSHP, OE ankues konsiderohet të ketë bërë kërkesën për rishqyrtim brenda afatëve kohore sipas ligjit për procedurën administrative dhe sipas nenit 108/A të LPP-së dhe nenit 4 të rregullave F03.

OSHP, sqaron se me vendimin 75/22, te datës 29 mars 2022, është vendosur qe te hedhet poshte ankesa e OE **"Vlera" SH.P.K. - Shtimje**, me arsyetimin se Spitali Regjional- Prizren për aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit" me nr. prokurimi "70010-22-851-2-2-1".
Me datën 21.02.2022, Autoriteti kontraktues ka publikuar Njoftimin për kontratë. Me datën 25.02.2022, ka publikuar Formulari Standard për korrigjim të gabimeve në Njoftimin e Publikuar. Hapja e ofertave është planifikuar të jete me dt.18.03.2022 në ora 12:00h. Operatori

ekonomik "Vlera shpk" ka dërguar tek AK kërkesën për rishqyrtim me datën: 13.03.2022 në ora 22.38h- që në kalendar figuron si ditë e dielë.

Pas pranimit të sqarimëve të ofruara, OSHP vendimin e lartcekur e shfuqizon duke marr parasysh faktin se duke u bazuar në nenin 81 (Llogaritja e afateve) të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 05/L -031, i cili në paragrafin 4 përcakton se: "*Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do të pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj*":

si dhe,

Nenit 108/A të LPP-së, e poashtu nenit 4 të Rregullave për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetëve Kontraktuese si dhe ankesave në OSHP ku thuhet:

4.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet te dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**

Organi Shqyrtues i Prokurimit, përkatësisht Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, pas pranimit të shkresës /për shfuqizim /anulim te vendimit 75/2022, i ka trajtuar dhe shqyrtuar me kujdes të njëjtat shkresa/ kërkesa dhe pas administrimit të të gjitha provave shkresore, ka konstatuar se ankesa e OE **"Vlera" SH.P.K. - Shtimje**, duke u bazuar në interpretim të dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative dhe Ligjit për Prokurim Publik, respektivisht legjislacionit sekondar, konsiderojmë se kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga OE ankues "Vlera shpk"- Shtimje, është brenda afatëve kohore, për faktin se afati i fundit për dorëzimin e kërkesës për rishqyrtim ka qenë 13 mars 2022, pesë ditë para hapjes së ofertave (hapja e ofertave është planifikuar me datën 18 mars 2022 në ora 12:00), ndërkaq data 13 mars 2022 ka qenë ditë e dielë, dhe duke u bazuar në atë se nëse afati i fundit i bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj, dhe në këtë rast si afat i fundit konsiderohet të jetë data 14 mars 2022 (ditë e hënë), pra pesë ditë para hapjes së ofertave.

Pra, në rastin konkret, edhe përkundër faktit se operatori ekonomik ka shfrytëzuar ditën e fundit të afatit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim, konsiderojmë se i njëjti është brenda afatit kohor për parashtrim.

Nga ana e OSHP-së për shkak sqarimeve të mangëta, gabimisht ka hedhur si te jashtafatshme ankesën e OE **"Vlera" SH.P.K. – Shtimje**.

Organi Shqyrtuesi i Prokurimit sqaron se do të vazhdoj me procedimin e ankesës së OE **"Vlera" SH.P.K. - Shtimje**, me numër të protokollit 75/22, të dorëzuar në mënyrë elektronike me datën 29 mars 2022, të parashtruar kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD) i objekteve të Spitalit me nr. prokurimi "70010-22-851-2-2-1", iniciuar nga AK Spitali Regjional- Prizren, në pajtim me nenin 113, 114, 116 dhe 117 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit konform nenit 53, të ligjit me nr. 05/L-031, Për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe duke u bazuar në atë që u përshkrua si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Sekretariatit te OSHP-së

Ardian BEHRA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Spitali regjional- Prizren

1x1 OE- **"Vlera" SH.P.K. - Shtimje**

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.